Mosha	Karakteristikat e zhvillimit	Rreziku kryesor	Kanosjet thelbësore	Disa këshilla
Java e pare deri 1 muaj		Rënie	• Krevati, peshore bebesh, tavolina e ndërrimit	• Mos e lini fëmijën vetëm mbi tavolinën e ndërrimit • Tavolinë ndërrimi me buzë anësore, të vendosur në tokë
		Djegie	• Temperatura e shishes së biberonit (furrë mikro-valë), borsë, banjë	• Temperatura e bolierit më pak se 50°C, të verifikohet temperatura me bërryl, të verifikohet temperatura e lëngjeve
		Mbytje	• Banjo	• Vaskë e përshtatshme dhe/ose ndenjëse me mbështetëse • Mos e lini fëmijën vetëm
~ 2 deri në 3 muaj	• Zvarritet • Kthehet në anësore	Asfiksi	• Litarë të hollë, zinxhir në qafë, shufra krevati, monedha, objekte të vogla	• Jo litarë të hollë, jo kafshë në dhomë, intervali i shufrave të krevatit : maksimumi 7,5 cm, rrethore krevati me përbërje cope, jo jastëk
		Makina	• Rënie/shok nëse fëmija nuk është i lidhur në një ndenjëse makine të përshtatshme për moshën dhe peshën e tij	• Mos e vini asnjëherë ndenjësen e makinës në sediljen e përparme në një makinë të paisur me airbag për pasagjerin • Ndenjësia e makinës e përshtatshme me moshën dhe peshën e fëmijës • Mos e lini fëmijën vetëm në makinë
~ 4 deri në 6 muaj	• Kap gjithshka që mund të kapi • Fut gjëra në gojë • Kthehet nga pozicioni me kurriz përmbys	Rënie	• Tavolina e ndërrimit, rrethore dhe shkallë, mobilje, krevat, karrikia e ngrënies	• Deriçkë sipër dhe poshtë shkallëve, fëmijë të lidhur në karrocë, qoshet e tavolinës
		Djegie	• Rubineti i ngrohtë, uji kur bën banjë, mbulesa e tavolinës, lëngjet e nxehta mbi tavolinë të ulët, dera e furrës	• Vendosni set tavoline, temperaturën e bolierit më pak se 50°C, të hapet uji i ftohtë përpara ujit të ngrohtë
		Mbytje	• Vaskë, pellgje me ujë	• Kur bën banjë : te kihet parasysh dispozitivi i mbajtjes, asnjëherë vetëm, edhe sikur të ketë vetëm pak ujë, tapet plastik kundër rrëshqitjes
		Asfiksi	• Zinxhir rreth qafës, litarë të hollë, qese plastike	• Evitoni mbajtjen e këtyre objekteve në dorë, diametri minimal në madhësinë e një topi pingpongu
~ 9 deri në 12 muaj	• Ngrihet duke u mbajtur • Qëndron ulur pa mbështetëse • Merr objekte të vogla • I lëshon objektet me dashje • Prek gjithshka • Ndryshon pozicion : ulur, me këmbë e me duar, ngrihet në këmbë	Helmimi	• Alkoli mbi tavolinë të ulët, ilaçet, produktet e pastrimit, insekticidet, bimët toksike	• Mos i lini andej-këndej, larg duarve të tyre, mbyllini në lartësi
		Trupa të huaj	• Objekte të vogla (kopsa, kapëse, lodra), ushqime të vogla (kikirikë)	• Jo lodra me pjesë të vogëla, larg duarve të tyre
		Goditjet elektrike	• Priza, aparate dhe fije elektrike, zgjatues elektrik te palidhur	• Mbrojtëse prizash, priza sigurie, rregulloni fijet dhe aparatet elektrike
		Prerje	• Objekte që thyhen, me teh	• Vendosini larg duarve të fëmijëve
		Makina	• Rënie/shok nëse fëmija nuk është i lidhur në një ndenjëse makine të përshtatshme	• Ndenjëse makine të përshtatshme për moshën e tij, në sediljen e prapme • Mos e lini fëmijën vetëm në makinë
~ 18 muaj	• Ecën dhe kacaviret vetëm, prapset • Ngjit dhe zbret shkallën duke u mbajtur • Fillon të përdorë filxhanin, lugën • Kurioz për të provuar dhe prekur gjithshka	Rënie	• Shkallë, karroca, mobilje, dritare, ballkone, krevatë të mbivendosur, qilima rrëshkitës, vënd lojrash	• Deriçka shkallësh, sigurim dritaresh, mos vini karrike përpara ballkonit/dritares, qilima jo rrëshqitës, mobilje të palëvizshme
		Djegie	• Rubinet me ujë të ngrohtë, furrë, kusi, hekur për hekurosje, aparat avulli, lëngje te nxehta	• Mbrojtëse për sobë gatimi /furrë, dorezë kusie me drejtim nga brënda, ushqimet e nxehta larg tyre
		Mbytje	• Pishinë, pellgje me ujë, vaskë	• Asnjëherë mos i lini vetëm, rrini pranë
		Asfiksi	• Qese plastike	• Mbajini larg tyre
		Trupa të huaj	• Objekte të vogla në vrimat e trupit (gojë, veshë, hundë...)	• Jo lodra me përmasa të vogla, mbajini larg tyre (diametri minimal në madhësinë e një topi pingpongu)
~ 24 muaj	• Imiton mjedisin shoqëror • Kupton shpjegime të tjeshta	Helmimi	• Ilaçe, produkte kozmetike, produktet e pastrimit, insekticidet, kokrrat e bimëve, bimët toksike	• Mos i lini andej-këtej, vendosini në lartësinë minimale :1.60 m
		Kafshime	• Kafshë shtëpiake të panjohura apo të njohura	• Mos i lini vetëm me kafshët, respektoni territorin e tyre, sidomos gjatë vaktit te ngrënies
~ 3 vjeç	• Hap sirtarë, dyer • Zhvidhos enët • Vë në qafë rruaza prej druri • Bën pyetje	Goditje elektrike	• Aparate të lidhura, zgjatues/fije elektrike të palidhura	• Hiqini aparatet nga korenti, vini në vënd materialet
		Prerje	• Objekte që thyhen apo me teh, makinë që qeth barin	• Rregulloini larg fëmijëve, evitoni objektet që mund të përmbysen
		Makina	• Rënie/shok nëse fëmija nuk është i lidhur në një ndenjëse makine të përshtatshme	• Ndenjëse makine të përshtatshme për moshën e tij, në sediljen e pasme, • Mos e lini fëmijën vetëm në makinë
~ 4 vjeç	• Kurioz, zbulon • Identifikohet me personat madhorë dhe i imiton ata • Do t'i bëjë të gjitha vetë	Rreziqe përjashta	• Ashensor, garazh, rrugë, shesh lojrash, pishinë	• Fjalori : mund t'ia shpjegojmë rreziqet • Të verifikohet toka në vendin e lojës, rroba me ngjyrë të çelët nëse del në rrugë
		Rënie	• Shkallë, dritare, ballkon, krevatë të mbivendosur, • Biçikletë	• Deriçkë shkallëve, sigurim i dritareve, mos vendosni karrike përpara ballkonit/dritares, qilim jo rrëshkitës, t'i mësohet zbritja e shkallëve • Kaskë biçiklete
		Djegie	• Shkrepse, çakmakë, qirinj, fishekzjarrë, furrë pjekjeje, kusi, zgarë	• Që nga mosha 3 vjeç e gjysëm, t'i mësohet të ndiejë nxehtësinë e objekteve, shkrepëset dhe çakmakët të palejueshëm
		Mbytje	• Pellgje me ujë, pishinë	• Mos e lini asnjëherë vetëm, t'i mësohet noti që në moshën 4 vjeç, të mbulohen sipërfaqet me ujë që ndodhen jashtë
~ 5/6 vjeç	• Pavarësia rritet • Nuk mund të llogarisë shpejtësinë e një automjeti • Identifikohet me personat madhorë dhe i imiton ata	Helmimi	• Produkte të pastrimit, ilaçe, kozmetikë, kokrrat e bimëve, kërpudha, bimë toksike	• Mos i lini andej-këtej, mbyllini në lartësi minimale: 1.60 m • Shpiegoni që është e ndaluar ngrënia e tyre
		Kafshime	• Kafshë shtëpiake të panjohura apo të njohura	• Të respektohet territori i tyre, kujdes me përkëdhelitë, sidomos gjatë vaktit të ngrënies
		Goditje elektrike	• Tharëse flokësh, trapan dhe aparate të tjera elektrike	• Mos i përdorni në dhomë të lagur, priza sigurie, hiqini aparatet nga korenti
		Prerje	• Objekte me teh, kuti konservash, vegla pune dhe kopshtarie	• Rregulloini larg duarve të tyre
		Makina	• Rënie/shok nëse fëmija nuk është i lidhur në një ndenjëse makine të përshtatshme	• Ndenjëse makine të përshtatshme me moshën, ne sediljen e pasme • Mos e lini fëmijën vetëm ne makinë

- **Evitoni ta lini fëmijën tuaj vetëm**
- **Jepini shëmbullin e mirë**
- **Përgëzojeni fëmijën për qëndrimet e tij të përshtatshme**

Të tundësh një bebe duke lozur me të apo sepse jeni të nevrikosur nga të qa-rat e tij është një veprim i rrezikshëm.
Ky gjest rrezikon të provokojë hemoragji cerebrale që mund të çojë në gjymtim ose dhe në vdekje.

urgjencat për shëndetin : 144

2008

Kjo fletëpalosje ju ofrohet nga :

PIPAD'ES,
Program Ndërkëmbimor
Mbi Parandalimin e Aksidenteve të Fëmijëve,
me mbështetjen e Shërbimeve të shëndetit publik
të kantoneve të Gjenevës, Tesinit dhe Vaud

PIPAD'ES
Les Ligues de la Santé
Av. de Provence 12
1007 Lausanne
Tël. 021 623 37 57
info@pipades.ch
www.pipades.ch

fondation planètes enfants malades
Fondacioni privat me qëllim jo përfitues,
Planeti Fëmijët e Sëmurë dëshiron të përmirësojë :

- cilësinë e jetës së fëmijës në spital
- mbështetjen ndaj prindërve
- marrjen në ngarkim të fëmijëve me të meta fizike dhe mendore dhe të sëmundjeve kronike
- kurimin e dhimbjes
- shëndetin e popullatës fëminore

Fondation Planètes Enfants Malades
Ch. de Montétan 16
1000 Lausanne 7
Tël. 021 627 22 44
contact@fpem.ch
www.fpem.ch

albanais

MANUAL PER MASAT PARANDALUESE DES KUNDER AKSIDENTEVE SHTEPIAKE PER FEMIJEN NGA MOSHA 0 DERI 5 VJEÇ

www.pipades.ch